



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:200320
Datë: 21.01.2025
Numri i dokumentit: 06736228

C.nr.591/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R. P.nga M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sheremet Ademi, avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti zhëmtim, jashtë seancës, më datë 21.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit R. P.nga M., e ushtruar kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.”, me seli në P., me objekt kontesti zhëmtim, në këtë çështje juridike kontestimore.
- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi R. P.nga M., pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.”, me seli në P. me objekt kontesti zhëmtim.

Lidhur me këtë çështje, gjykata më datë ... ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit përgatitor në të cilën për paditësen ka prezentuar avokat Leutrim Ademi nga Mitrovica, për të cilin gjykata nuk ka pasur autorizim për përfaqësim në shkresat e lëndës, e të cilin gjykata me aktvendim të nxjerr në kuadër të procesverbalit e ka obliguar që brenda afatit prej ...ditësh nga dita e mbajtjes

së kësaj seance, gjykatës t'i prezentoj autorizimin për përfaqësimin e paditëses në formë të shkruar, duke e paralajmëruar njëkohësisht edhe për pasojat e mosveprimit konform këtij aktvendimi.

Gjykata gjen se afati i fundit që avokati në fjalë ka pasur mundësi të dorëzoj autorizimin për përfaqësim ka qenë data ..., mirëpo deri në kohën e nxjerrjes së këtij aktvendimi, avokati nuk e ka dorëzuar autorizimin për përfaqësim, duke i dhënë kështu shkas lindjes së pasojave të paralajmëruara me aktvendimin e datës ..., që nënkupton se veprimet e marra nga avokati Leutrim Ademi në seancën e datës ..., konsiderohen se nuk janë ndërmarrë asnjëherë, rrjedhimisht duke qenë se ftesën për këtë seancë gjyqësore në emër të paditëses e ka pranuar i autorizuari i saj Sheremet Ademi, avokat nga Mitrovica, i cili megjithëse i fuar në mënyrë të rregullt për këtë seancë gjyqësore, në seancë nuk ka prezentuar dhe mosprezencën nuk e ka arsyetuar, gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 409 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.”*, vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.591/2015 më datë 21.01.2025

Gj y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.